



EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS  
COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME  
GJYKATA EUROPIANE E  
TË DREJTAVE TË NJERIUT

Deklaratë për Shtyp  
Lëshuar nga Regjistruesi i Gjykatës.

### Versionet e mëparshme të rregullave të emigracionit ishin diskriminues kundrejt disa refugjatëve dhe partnerëve të tyre.

Në vendimin e sotëm të Dhomës, në rastin e Hode & Abdi v. Mbretërinë e Bashkuar (padija me numër. 22341/09), i cili s'është i formës së prerë<sup>1</sup>, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut njëzëri vendosi se ka pasur:

**Një shkelje të Nenit 14 (ndalimi I diskriminimit) së bashku me Nenin 8 (e drejta e për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.**

Çështja kishte të bënte me refuzimin për t'i dhënë gruas së një refugjati të drejtën për të hyrë në Mbretërinë e Bashkuar. Edhe pse z. Hode ishte refugjat, paditësi nuk u kualifikua për "bashkim familjar" sipas Rregullores së Imigracionit, sepse martesja kishte ndodhur pasi ai ishte larguar nga Somalia. Për më tepër, z. Hode i ishte dhënë leje 5 vjeçare për të qëndruar, znj. Abi i bashkohej atij si bashkëshortja e një personi që i pranishëm dhe rezident në Mbretërinë e Bashkuar.

Gjykata vlerësoi në mënyrë të veçantë se dallimi në trajtim midis paditësve dhe kategorive të tjera të imigrantëve nuk ka qenë i justifikuar në mënyrë objektive dhe të arsyeshme. Si rrjedhojë, ajo është mbështetur në një pjesë të vendimit të shkallës së Lartë të Tribunalit<sup>2</sup> (Azil dhe Imigracion), në të cilin s'është gjetur asnjë lloj justifikimi për pozitën e veçantë të pafavorshme të partnerëve të refugjatëve<sup>3</sup> pas mbërritjes së të parëve në këtë rast, Gjykata i ka kërkuar Sekretarit të Shtetit që të tregojë vëmendje urgjente në ndryshimin e Rregullores së Emigracionit. Rregullat e Emigracionit ishin ndryshuar më pas në vitin 2011 për të lejuar partneret e refugjatëve t'ju bashkohen atyre edhe më vonë gjatë periudhës së tyre fillestare për të qëndruar aty.

---

<sup>1</sup> Bazuar në nenin 43 dhe 44 të Konventës, ky vendim i Dhomës s'është i formës së prerë. Gjatë periudhës tre mujore nga dhënia e vendimit, secila mund të kërkojë që rasti të dërgohet në Dhomën/Shkallën e Lartë të Gjykatës. Nëse bëhet një kërkesë e tillë, një panel prej 5 gjyqtarësh konsideron nëse rasti meriton shqyrtime të mëtejshme. Në këtë rast, Dhoma/Shkalla e Lartë do ta dëgjojë rastin dhe do të japë një vendim të formës së prerë. Nëse kërkesa për rishqyrtim refuzohet, vendimi i Dhomës bëhet i formës së prerë atë ditë. Pasi një vendim të bëhet i prerë, ai transmetohet tek Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës për mbikëqyrje të ekzekutimit të tij. Informacioni i mëtejshëm rreth procesit të informacionit mund të gjendet këtu: [www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution](http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution)

<sup>2</sup> FH (Post-flight spouses) Iran [2010] UKUT 275

<sup>3</sup> Bashkëshortët të cilët martoheshin me refugjatë pasi ai ose ajo largoheshin nga vendi ose venbanimi i përhershëm i tyre.

## Faktet Kryesore

Ankuesit, Ilyas Elmi Hode, një shtetas Somalez dhe Hawa Aden Abdi, një shtetase nga Djibouti, burrë e grua, kanë lindur respektivisht me 13 shkurt 1980 dhe 15 Janar 1990. Z.Hode jeton në Lids (Leeds) (Mbretëri e Bashkuar ) dhe znj. Abdi në Djibouti. Z. Hode mbërriti në Mbretërinë e Bashkuar me 18 shkurt 2004. Kërkesa e tij për azil u pranua në mars të vitit 2006 dhe atij iu dha leje 5 vjeçare për të jetuar në Mbretërinë e Bashkuar, leje e cila skadonte në mars të vitit 2011. Z. Hode u njoh me znj Abdi në qershor të vitit 2006, kur po jetonte në Djibouti. Në prill të vitit 2007 ata u martuan në Djibouti dhe z. Hode u rikthye në Mbretërinë e Bashkuar në maj të vitit 2007. Paditësit më pas bënë dy fëmijë, të cilët u lindën në shkurt 2008 dhe korrik 2011.

Aplikimi i znj. Abdi për një vizë për t'iu bashkuar bashkëshortit të saj në Mbretërinë e Bashkuar bazuar në dispozitat e ribashkimit të familjarëve të refugjatëve u refuzua nga një Oficer Emigracioni, pasi këto dispozita aplikoheshin vetëm për anëtarët e familjes, të cilët kanë qenë pjesë e familjes së refugjatit kur këta të fundit janë larguar nga vendi i tyre i rezidencës së përhershme. Asaj gjithashtu iu refuzua e drejta për të hyrë si partnere e një personi të pranishëm dhe të rezident në Mbretërinë e Bashkuar, sepse Z. Hode i ishte dhënë leje 5 vjeçare për të qëndruar. Në apel, një Gjykatës Emigracioni pranoi se z. Hode ka fonde të mjaftueshme për të mbështetur familjen e tij dhe se e drejta e paditësit bazuar në Nenin 8 ishte e aplikueshme. Megjithatë, ai konstatoi se refuzimi i një vize nuk përbënte shkelje disproporcionale me të drejtat e tyre familjare, pasi znj. Abdi asnjëherë s'kishte pasur mundësi t'i gëzohej jetës familjare në Mbretërinë e Bashkuar dhe se pengesa e vetme që mund të pengonte z. Hode të jetonte në Djibouti ishte se ai s'mund të fliste frëngjisht dhe do ta kishte të pamundur të gjente një punë atje.

Leja 5 vjeçare për të qëndruar në Mbretërinë e Bashkuar skadoi në mars të vitit 2011 dhe më pas atij i është dhënë leje pa afat për të qëndruar.

Në prill të vitit 2011 Rregullat e Emigracionit u ndryshuan për t'ju mundësuar refugjatëve që partnerët e tyre t'ju bashkohen në Mbretërinë e Bashkuar edhe pasi ata të kishin shkelur Mbretërinë gjatë periudhës fillestare për të qëndruar, duke pasur parasysh se plotësohen një sërë kushtet të tjera.

Ankesat, procedura dhe përbërja e Gjykatës

Duke u bazuar në nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), paditësit u ankuan ndaj refuzimit që iu bë znj Abdi për të marrë vizë për në Mbretërinë e Bashkuar. Ata pretenduan se janë trajtuar më keq sesa kategoritë e tjera të emigrantëve, si refugjatët që ishin martuar para se të largoheshin nga vendi i tyre i qëndrimit të përhershëm dhe të studentëve ose punëtorë. Të gjitha këto kategori të emigrantëve kanë pasur të drejtë që të bashkohen në Mbretërinë e Bashkuar nga bashkëshortët e tyre, dhe në rastin e studentëve dhe punëtorëve s' është bërë asnjë dallim mes martesat që janë bërë para se atyre t'ju jepej leje për të qëndruar në Mbretërinë e Bashkuar dhe martesave që ndodhën pas dhënies së lejes.

Ankesa u depozitua në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut me 25 mars 2009.

Vendimi u dha nga një Dhomë prej 7 gjyqtarësh, të përbërë si më poshtë:

Lech Garlicki (Poloni), Kryetar,  
David Thór Björgvinsson (Islandë),  
Nicolas Bratza (Mbretëri e Bashkuar),  
Päivi Hirvelä (Finlandë),  
George Nicolaou (Qipro),  
Ledi Bianku (Shqipëri),  
Vincent A. de Gaetano (Maltë),

si dhe Fato Araci, Zëvendës Regjistrues i Seksionit.

### **Vendimi i Gjykatës**

Neni 14 në lidhje me nenin 8

Gjykata konstatoi se ky rast erdhi brenda dispozitave të Nenit 8, pasi Rregullat e Emigracionit kanë pasur ndikim të dukshëm mbi mundësinë e paditësit për të ndërtuar familjen së bashku dhe të gëzojnë së jetuari në një njësi familjare.

Gjykata solli në vëmendje se të vetmin dallim në trajtim bazuar në një karakteristikë të identifikueshme, ose “status” ka çuar në diskriminim brenda kuptimit të Nenit 14. Dispozita listoi baza specifike të cilat përbënin “statusin”, duke përfshirë gjininë, racën dhe pronën, si dhe “ndonjë status” tjetër, fjalë të cilave u është dhënë një kuptim i gjerë në përgjithësi nga Gjykata dhe s’kanë qenë kufizuar vetëm në karakteristikat natyrore dhe të qenësishme të një personi. Ajo gjithashtu solli në vëmendje<sup>4</sup> faktin se statusi i emigracionit ishte një status i dhënë më ligj, sesa një natyral për ndonjë individ, dhe kjo nuk e pengonte atë të merrte një “tjetër status” për qëllime të Nenit 14. Megjithatë, ndryshe nga statusi i emigracionit, statusi i refugjatit, nuk përfshinte një element zgjedhjeje. Gjykata si rrjedhojë erdhi në përfundim se paditësit gëzonin “statuse të tjerë” për qëllimin e Nenit 14.

Për sa i përket dallimit në trajtim për persona në situata të ngjashme brenda kuptimit të Nenit 14, Gjykata konsideroi se refugjatët të cilët janë martuar para se largoheshin nga vendi i tyre i rezidencës së përhershme kanë qenë në një pozitë të ngjashme me atë të paditësve pasi të gjithëve u ishte garantuar statusi i refugjatit dhe leje për të qëndruar për një kohë të kufizuar. Njëlloj, si studentët e punonjësit të cilëve u është dhënë një leje për një periudhë të kufizuar të qëndrojnë në Britani dhe gjykata gjithashtu pranoi se ata ishin në situata të ngjashme me atë të paditësve për qëllimin e Nenit 14 të Konventës.

Gjykata më tej shqyrtoi nëse dallimi në trajtim ka qenë i justifikuar në mënyrë objektive dhe të arsyeshme. Ajo pranoi se t’u ofrosh stimuj një grupi të caktuara emigrantësh – ashtu siç kishte bërë Qeveria për studentët dhe punonjësit - do të mund të konsiderohet si një qëllim legjitim. Megjithatë, Gjykata vërejti se justifikimi nuk ishte dhënë në një rast të kohëve të krahasueshëm

---

<sup>4</sup> Bah kundër Mbretërisë së Bashkuar, 27.09.2011

kohëve të fundit në gjykatat vendase<sup>5</sup>. Në fakt, në këtë rast Shkalla e Lartë e tribunalit (Azili dhe Emigracionin) s'kishte gjetur asnjë justifikim për pozitën posaçërisht të pafavorshme të refugjatëve në krahasim me studentët dhe punëtorët dhe i kishte bërë thirrje të Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Punëve të Brendshme të ndryshojë urgjentisht rregullat e emigrimit në mënyrë që të zgjerojë ata për bashkëshortët e atyre me leje të kufizuar për të qëndruar si refugjatë, që vijnë pas mbërritjes së këtyre të fundit.

Gjykata gjithashtu konsideroi se s'ka pasur një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv për të trajtuar refugjatët të cilët marrohen pasi janë larguar nga vendi i tyre me ata që marrohen para se të largohen.

Si rrjedhojë, Gjykata nuk konsideroi se dallimi në trajtim ka qenë i justifikuar në mënyrë të arsyeshme dhe objektive dhe konstatoi se ka pasur një shkelje të Nenit 14 në lidhje me nenin 8. Sidoqoftë, ajo vuri në dukje se situata që ka çuar në këtë shkelje nuk ekzistonte më pasi më pas Rregullat e Emigracionit janë ndryshuar.

Dëmshpërblime (Neni 41)

Gjykata konstatoi se Mbretëria e Bashkuar duhej t'i paguante ankuesit 1,000 euro (EUR) si dëm financiar dhe 6,000 euro si dëm jo-pasuror.

Vendimi është i mundur vetëm në gjuhën Angleze.

Kjo deklaratë për shtyp është një dokument i lëshuar nga Zyra e regjistrimit. Nuk e detyron Gjykatën. Vendimet, gjykimet dhe informacione të tjera rreth gjykatës mund të gjenden në: [www.echr.coe.int](http://www.echr.coe.int). Për të marrë deklaratat për shtyp të gjykatës ju lutem regjistrohuni këtu: [www.echr.coe.int/RSS/en](http://www.echr.coe.int/RSS/en).

[echrpress@echr.coe.int](mailto:echrpress@echr.coe.int) | tel: +33 3 90 21 42 08

Céline Menu-Lange (tel: + 33 3 90 21 58 77)

Tracey Turner-Tretz (tel: + 33 3 88 41 35 30)

Nina Salomon (tel: + 33 3 90 21 49 79)

Denis Lambert (tel: + 33 3 90 21 41 09)

**Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut** u krijua në Strasburg nga Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës në vitin 1959 për trajtimin e shkeljeve të pretenduara të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut të vitit 1950.

---

<sup>5</sup> FH (Post-flight spouses) Iran [2010] UKUT 275, in 2010